



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 87, datë 17.06.2019

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM DHE SHPALLJEN E NJË POZICIONI TË LIRË PËR TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË DURRËS

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, duke patur në konsideratë edhe vendimin nr.47, date 13.06.2018, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, “Mbi transferimin e përkohshëm të Gjyqtarëve në disa Gjykata”, i cili ndër të tjera, ka vendosur transferimin e përkohshëm për 1 (një) vit, edhe të një gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për transferim të përkohshëm deri në një vit.
2. Thirrja për transferim t'i drejtohet gjyqtarit të transferuar aktualisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, i cili ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.
3. Afati për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm të jetë 3 ditë, duke filluar nga dita e publikimit të thirrjes në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
4. Ngarkohet Komisioni për Zhvillimin e Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR